

*Zyra e Rregullatorit për Energji
Rr. Hamdi Mramori Nr. 1
Prishtinë10000– Kosovë
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org*

Zyra e Rregullatorit për Energji

**Rregulla për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit
(Rregulla për çmimet e OST-së)**

D R A F T

2011

PËRMBAJTJA

| | | |
|-------------|--|----|
| Kapitulli 1 | Kushtet e Përgjithshme | 3 |
| Neni 1 | Hyrje | 3 |
| Neni 2 | Qëllimi dhe fushëveprimi | 3 |
| Neni 3 | Definicionet dhe përkufizimet | 3 |
| Kapitulli 2 | Ngarkesat Tuos | 7 |
| Neni 4 | Parimet e Përgjithshme | 7 |
| Neni 5 | Rishikimet periodike dhe Periudhat Rregullative | 7 |
| Neni 6 | Përshtatjet e Rregullta | 8 |
| Neni 7 | Shqyrtimet e Jashtëzakonshme | 8 |
| Neni 8 | Parimet Themelore | 9 |
| Neni 9 | Shpenzimet e Lejuara Operative | 10 |
| Neni 10 | Zhvlerësimi i Lejuar | 10 |
| Neni 11 | Kostoja e Kthimit në Kapital | 10 |
| Neni 12 | Kostot e Lejuara të Humbjeve | 10 |
| Neni 13 | Bartja e Taksës së Licencës | 11 |
| Kapitulli 4 | Ngarkesat për TUOS | 12 |
| Neni 14 | Parimet e Përgjithshme | 12 |
| Neni 15 | Procedura për Aprovimin e Ngarkesave TUOS | 12 |
| Kapitulli 5 | Ngarkesat për Operator të Sistemit | 13 |
| Neni 16 | Parimet e Përgjithshme | 13 |
| Neni 17 | Procedura për Aprovimin e Ngarkesave për Operatorin e Sistemit | 13 |
| Kapitulli 6 | Ngarkesat për Operator të Tregut | 14 |
| Neni 18 | Parimet e Përgjithshme | 14 |
| Neni 19 | Procedura për Aprovimin e Ngarkesave për Operatorin e Tregut | 14 |
| Kapitulli 7 | Taksat për Kyçje | 15 |
| Neni 20 | Parimet e Përgjithshme | 15 |
| Neni 21 | Procedura për Aprovimin e Taksave për Kyçje | 15 |
| Kapitulli 8 | Ngarkesat për Skemen Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme | 16 |
| Neni 21 | Parimet e Përgjithshme | 16 |
| Shtojca 1 | Llogaritja e Të Hyrave Maksimale të Lejuara | 17 |
| Shtojca 2 | Baza e Aseteve të Rregulluara | 20 |
| Shtojca 3 | Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit | 22 |
| Shtojca 4 | Shërbimet e Përrjashtuara | 24 |
| Shtojca 5 | Procesi i Shqyrtimit Periodik | 26 |
| Shtojca 7 | Procesi i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm | 29 |
| Shtojca 9 | Ngjara e Forcës Madhore | 32 |

KAPITULLI 1 KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Hyrje

- 1 Kjo Rregull është miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (“Rregullatorit”) në seancën publike të mbajtur më [data], në bazë të autoritetit të dhënë në Nenin 8 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 2 Qëllimi dhe fushëveprimi

- 2 Kjo Rregull cakton:
 - 2.1 Bazën për vlerësimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara që Operator i i Sistemit të Transmisionit (OST) mund të përfitojë në një Vit Relevant, në mënyrë që OST të mbulojë kostot e arsyeshme të mirëmbajtjes dhe të operimit të sistemit të transmisionit për shërbimin ndaj konsumatorëve në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë; dhe,
 - 2.2 Procedurën sipas së cilës të Hyrat Maksimale të Lejuara do të Shqyrtohen dhe do të ri-vlerësohen periodikisht.

Neni 3 Definicionet dhe përkufizimet

- 3 Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë këtë kuptim:
 - 3.1 “Të Hyra të Rregulluara Aktuale” nënkupton të Hyrat e mbuluara nga OST përmes ngarkesave për kryerjen e shërbimeve të sistemit të transmisionit dhe operatorit të tregut si dhe të gjitha të hyrat e tjera të përcaktuara nga rregullatori e të matura në baza aktuale;
 - 3.2 “Plan i Aprovuar Investiv” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;
 - 3.3 “Ditë Pune” quhen të gjitha ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas Ligjeve në Kosovë;
 - 3.4 “Taksë për Kycje” nënkupton taksën e aplikuar nga OST për kyçjen e konsumatorëve në Sistemin e Transmisionit
 - 3.5 “Jetëgjatësia Ekonomike” nënkupton jetëgjatësinë e përdorur për llogaritjen e zhvlerësimit të lejuar nga Baza e Aseteve të Rregulluara;
 - 3.6 “EURIBOR” nënkupton Normën e Ofrimit për Depozita të Euros nga Federata Bankare Evropiane për periudhë 3 mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të Reuters në ora 11:00 (kohë e matur sipas Kohës Qendrore Evropiane) ose, në rast se Reuters nuk vazhdon ta ofrojë këtë shërbim, cilado agjenci tjetër e pajtuar në mes të OST-së dhe Rregullatorit. Për shmangje të dyshimit kjo do të jetë normë vjetore;
 - 3.7 “Shërbimet e Përrjashtuara” nënkuptojnë shërbimet e ofruara nga OST si pjesë e aktiviteteve të licencuara, kostot e të cilave mbuloohen jashtë Të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen me, kryerjen e kyçeve në Sistemin e Shpërndarjes, transitin apo provizionet për shërbimet nga kërkesat e palëve të treta;

- 3.8 “Përshtatje e Jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 3.9 “Ngjarje e Jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
- 3.10 “Shqyrtim i Jashtëzakonshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7;
- 3.11 “Forcë Madhore” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 9;
- 3.12 “Taksa për Licencë” nënkupton shumën për pagesë sipas Nenit 7 të Pasqyrës së Taksave, që lëshohet nga Rregullatori dhe mund të amandamentohet;
- 3.13 “Caku i Humbjeve” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 12 paragrafin 3;
- 3.14 “Faktori i Ndarjes së Humbjeve” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 12 paragrafin 4;
- 3.15 “Shërbimet e Operimit të Tregut” nënkupton shërbimet të cilat i Licencuari për OST është i autorizuar t’i ofrojë sipas kushteve të Licencës për Operim të Tregut të dhënë nga Rregullatori .
- 3.16 “Ngarkesa e Operimit të Tregut” nënkupton ngarkesat e aplikuara nga OST për pjesën e shërbimeve të Operimit të Tregut ;
- 3.17 “Rregullat e Tregut” ka kuptimin [do të definohen me rastin e përcaktimit të Rregullave të Tregut];
- 3.18 “Pragu i Materialitetit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 3.19 “Të Hyra Maksimale të Lejuara” ose “MAR” nënkuptojnë të Hyrat maksimale që mund të mbulohen brenda një Viti Relevant nga OST përmes Ngarkesave TUOS e të cilat caktohen sipas formulave të Shtojcës 1 të kësaj Rregulle;
- 3.20 “Kërkesa Maksimale e Sistemit të Transmisionit” nënkupton kërkesën maksimale të energjisë elektrike brenda një viti (në MW) të matur në pikat hyrëse të Sistemit të Transmisionit së OST-së;
- 3.21 “E Matur” nënkupton çdo sasi të matur të energjisë elektrike, në pajtim me matësin e instaluar sipas Kodit të Matjes;
- 3.22 “MW” nënkupton megavat;
- 3.23 “MWh” nënkupton megavat-orë;
- 3.24 “Vlera Neto e Tanishme” nënkupton metodën e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë;
- 3.25 “Propozim” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5 paragrafin 4;
- 3.26 “Vendim i Përkohshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5 paragrafin 6;
- 3.27 “Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike” ose “PES” nënkupton bartësin e Licencës për Furnizim Publik;
- 3.28 “Shqyrtimi Periodik” nënkupton shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara të OST-së për Periudhën Rregullative vijuese;

- 3.29 “Përshtatje e Rregullt” nënkupton përshtatjen Mekanike të të Hyrave Maksimale të Lejuara që bëhet rreth fundit të çdo Viti Relevant;
- 3.30 “Njësitë e Rregulluara të Faturuara” nënkuptojnë shumën e energjisë elektrike të faturuar ndaj konsumatorëve Kosovarë në raport me njësitë e furnizuara ndaj tyre nga Sistemi i Transmisionit;
- 3.31 “Njësitë e Rregulluara të Transmetuara” nënkuptojnë shumën e energjisë elektrike të shpërndarë përmes Sistemit të Transmisionit për konsumatorët Kosovarë brenda një Viti Relevant, të matur në pikat dalëse të Sistemit të Transmisionit (ose, në rastet kur nuk ka matës, të vlerësuara sipas praktikave të njohura inxhinierike);
- 3.32 “Rregullatori” nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji;
- 3.33 “Baza e Aseteve të Rregulluara” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;
- 3.34 “Periudhë Rregullative” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5 paragrafin 3;
- 3.35 “Vit Relevant” nënkupton periudhën prej 12 muajsh në mes të Përshtatjeve të Rregullta;
- 3.36 “Fondi për Energjinë e Ripërtërishme” nënkupton një fond të krijuar dhe të drejtuar nga Operatori i Tregut në përputhje me Rregullen për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës siq është e publikuar nga Rregullatori, në emër të së cilës një konto e ndarë bankare do të formohet.
- 3.37 “Skema Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme” nënkupton një ngarkesë të përcaktuar nga Rregullatorinë përputhje me rregullen e publikuar për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës , e që azhurnohet kohë pas kohe.
- 3.38 “Deklaratë për Parimet e Ngarkesave të Transmisionit” nënkupton deklaratën e lëshuar nga Rregullatori me të cilën duhet të jenë në pajtueshmëri Metodologjitë e OSST-së për përcaktimin e Ngarkesave TUOS dhe Taksave për Kycje;
- 3.39 “Deklaratë mbi Ndikimin Financiar” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 3.40 “Ngarkesa e Operimit të Sistemit” nënkupton ngarkesat e aplikuara nga OST për pjesën e shërbimeve të Operimit të Sistemit;
- 3.41 “Shërbimet e Operimit të Sistemit” nënkupton shërbimet të cilat i Licencuari për OST është i autorizuar t’i ofrojë sipas kushteve të Licencës për Operim të Sistemit të dhënë nga Rregullatori .
- 3.42 “Humbjet në Transmision” nënkuptojnë totalin e energjisë së humbur në Sistemin e Transmisionit të operuar nga OST dhe përbëhen nga (1) humbjet teknike, të përcaktuara nga vlerësimet inxhinierike, dhe (2) humbjet komerciale, të cilat përfshijnë energjinë në hyrje të Sistemit të Transmisionit por nuk përfshijnë humbjet teknike dhe energjinë e faturuar te konsumatorët;
- 3.43 “Sistemi i Transmisionit” ka kuptimin e dhënë në Ligjinë për Energji Elektrike
- 3.44 “Operatori i Sistemit të Transmisionit” ose “OST” nënkupton autoritetin juridik që është pronar i Sistemit të Transmisionit në Kosovë dhe që është bartës i Licencës për Operator të Sistemit të Transmisionit;

- 3.45 ‘Shërbimet e Sistemit të Transmisionit’ nënkupton shërbimet të cilat i Licencuari për OST është i autorizuar t’i ofrojë sipas kushteve të Licencës për Operim të Sistemit të dhënë nga Rregullatori , përfshirë Shërbimin e Operatorit të Sistemit dhe shfrytëzimin e Shërbimeve të Sistemit
 - 3.46 “Ngarkesa OST” nënkupton ngarkesat e aplikuara nga OST, përfshirë Ngarkesat e TUOS, Ngarkesat e Operimit të Sistemit, dhe Ngarkesat e Operimit të Tregut ;
 - 3.47 “Ngarkesa TUOS” nënkupton ngarkesat e aplikuara nga OST për ofrimin e Shfrytëzimit të Shërbimeve të Sistemit;
 - 3.48 Njësi e shpërndarë” nënkupton një kilovat-orë;
 - 3.49 “Shfrytëzim i Sistemit” nënkupton shfrytëzimin e Sistemit të Transmisioni për shpërndarje të energjisë elektrike nga pika hyrëse deri në pikat e furnizimit për konsumatorët Kosovarë;
 - 3.50 “Mesatare e Ponderuar e Kostos së Kapitalit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3; dhe
 - 3.51 “X-faktori” nënkupton faktorin e përcaktuar në Shqyrtimet Periodike dhe të aplikuar në kostot e lejuara të TUOS gjatë Përshatjeve të Rregullta.
- 4 Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.

KAPITULLI 2 NGARKESAT TUOS

Neni 4 Parimet e Përgjithshme

Ngarkesat e OST-së do të përfshijnë Ngarkesat e TUOS (Kapitulli 4), Ngarkesat e Operatorit të Sistemit (Kapitulli 5) dhe Ngarkesat e Operatorit të Tregut (Kapitulli 6).

- 1 Ngarkesat vjetore TUOS duhen caktuar ashtu që:
 - 1.1 Brenda çdo Viti Relevant, të hyrat që OST pres të mbledhë nga Ngarkesat TUOS janë të barabarta me Të Hyrat Maksimale të Lejuara (Kapitulli 3) të aprovuara nga Rregullatori; dhe
 - 1.2 Ngarkesat vjetore TUOS përcaktohen në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST dhe të aprovuar nga Rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Deklaratën për Parimet e Ngarkesave të Transmisionit”, të lëshuar nga Rregullatori.
- 2 Të Hyrat Maksimale të Lejuara përbëhen nga shuma e:
 - 2.1 Kostove të Lejuara TUOS, duke përfshirë këtu kostot e lejuara operative, zhvlerësimin e lejuar dhe kthimin e lejuar në kapital;
 - 2.2 Kostot e lejuara të humbjeve;
 - 2.3 Taksën për Licencë; dhe
 - 2.4 Kostot e obligimeve për shërbim publik që nuk mbulohen nga ndonjë mekanizëm tjetër.
- 3 Kur OST pranon të ardhura nga provizionet e shërbimeve tranzitore, ato të ardhura do të kompenzohen në të Hyrat Maksimale të Lejuara, deri në atë nivel që të ardhurat nga tranziti gjenerohen nga shfrytëzimi i asteve që janë paguar nga Qeveria e Kosovës apo nga konsumatorët e Kosovës.
- 4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përcaktohen si vijon:

Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të caktohen në Shqyrtimet Periodike (Neni 5)

 - 4.1 Para përfundimit të çdo Viti Relevant do të aplikohet një Përshtatje e Rregullt (Neni 6) që përfshinë përshtatjet mekanike për të Hyrat Maksimale të Lejuara për ndryshimin në kostot që janë jashtë kontrollit të OST-së; dhe
 - 4.2 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme (Neni 7), që përfshijnë përshtatjet në të Hyrat Maksimale të Lejuara si rezultat i ndryshimeve materiale të kostove të TUOS të shkaktuara nga një Ngjarje e Jashtëzakonshme, mund të ndodhin sipas nevojës.

Neni 5 Rishikimet periodike dhe Periudhat Rregullative

- 1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OST-në për Periudhën Rregullative do të caktohen gjatë Rishikimeve Periodike.
- 2 Rishikimet Periodike do të mbahen para çdo Periudhe Rregullative.

- 3 Secila Periudhë Rregullative do të jetë 5 vjeçare, përveç: Në rast të pajtimit në mes të OST-së dhe Rregullatorit, Periudha Rregullative mund të shkurtohet apo zgjatet;
- 4 Procedura për mbarëvajtjen e Shqyrtimeve Periodike është dhënë në Shtojcën 5.

Neni 6 Përshtatjet e Rregullta

- 1 Gjatë Përshtatjeve të Rregullta do të llogariten ndryshimet e lejuara të të Hyrave Maksimale të Lejuara.
- 2 Përshtatjet e Rregullta do të bëhen para çdo Viti Relevant vijues.
- 3 Ndryshimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara gjatë çdo Përshtatjeje të Rregullt do të bazohet në:
 - 3.1 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara gjatë Vitit Relevant të tanishëm, për shkak të diferencave në mes të shpërndarjes së parashikuar të energjisë elektrike dhe shpërndarjes së realizuar të energjisë elektrike;
 - 3.2 Përshtatjet në të Hyrat Maksimale të Lejuara për ndryshimet në kostot e lejuara të humbjeve (Neni 12) dhe koston e parashikuar të Taksave të Licencës (Neni 13); dhe
 - 3.3 Nën-mbulimi apo mbi-mbulimi i kostove të lejuara të humbjeve dhe të Taksave të Licencës që mund të vijnë si pasojë e ndryshimeve të kostove të parashikuara dhe atyre të realizuara por që kufizohen nga mekanizmat e ndarjes të këtyre mbulesave në mes të OST-së dhe të shfrytëzuesve të Sistemit të Transmisionit
- 4 Formulatat për llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara gjatë Përshtatjeve të Rregullta janë dhënë në Shtojcën 1.
- 5 Procedura për realizimin e Përshtatjeve të Rregullta është dhënë në Shtojcën 6.

Neni 7 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga Ngjarjet e Jashtëzakonshme, të definuara sipas Shtojcës 8.
- 2 Gjatë Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i Ngjarjes së Jashtëzakonshme në të Hyrat Maksimale të Lejuara për pjesën e mbetur të Periudhës Rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se Pragu i Materialitetit, atëherë do të bëhet Përshtatje e Jashtëzakonshme;
- 3 Llogaritja e ndikimit mbi të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe e Përshtatjes së Jashtëzakonshme nuk duhet të marrë parasysh faktorë të cilët nuk janë të ndërlidhur në mënyrë direkte me Ngjarjen e Jashtëzakonshme.
- 4 Për shmangje të dyshimit, Rregullatori do të marrë parasysh ndikimin e Ngjarjeve të Jashtëzakonshme (që e kalojnë Pragu e Materialitetit) në Shqyrtimet Periodike pasuese.
- 5 Procedura për mbarëvajtjen e Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme është dhënë në Shtojcën 7.

KAPITULLI 3 TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA

Neni 8 Parimet Themelore

- 1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të caktohen në atë masë që i mundësojnë OST-së të caktojë Ngarkesa TUOS, Operatorit të Tregut dhe Ngarkesat e operatorit të Sistemit në nivel që mundësojnë mbulimin e të gjitha kostove të arsyeshme për ofrimin e Shërbimeve të Sistemit të Shpërndarjes deri në atë masë ku kostot janë të justifikuara dhe të vlerësuara me kujdes.
- 2 Kostot e arsyeshme të OST-së përfshijnë:
 - 2.1 Kostot e Lejuara TUOS, duke përfshirë kostot operative (Neni 9), kostot e zhvlerësimit (Neni 10) dhe kostot e kthimit në kapital (Neni 11). Gjatë Përshtatjeve të Rregullta, kostot e lejuara TUOS do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin , për të zbritur X-faktorin dhe për të marrë parasysh ndryshimet në Kërkesën Maksimale të Sistemit të Transmisionit, Njësitë e Rregulluara të Shpërndara si dhe numrin e konsumatorëve përderisa kostot e lejuara vlerësohen në këtë mënyrë;
 - 2.2 Kostot e lejuara të humbjeve (Neni 12) të cilat do të bazohen në Cakun e Humbjeve dhe do të barten gjatë Përshtatjeve të Rregullta bazuar në Faktorin e Ndarjes së Humbjeve;
 - 2.3 Taksa e Licencave (Neni 13), që do të bartet në mënyrë të plotë gjatë Përshtatjeve të Rregullta; dhe
 - 2.4 Kostot e shërbimeve publike që nuk mbulohen nga ndonjë mekanizëm tjetër.
- 3 Gjatë përcaktimit të kostove të lejuara, Rregullatori do t'u referohet, në mes tjerash edhe:
 - 3.1 Performancës së kaluar;
 - 3.2 Performancës së parashikuar;
 - 3.3 Krahasimeve me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë; dhe
 - 3.4 Krahasimeve me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe gjetiu në Evropë.
- 4 Të Hyrat Maksimale të Lejuara nuk do të mbulojnë kostot e shërbimeve të tjera (duke përfshirë edhe koston e ndërtimit të linjave) të cilat konsiderohen si Shërbime të Përrjashtuara sipas Shtojcës 3 duke përfshirë:
 - 4.1 Shërbime nga të cilat përfiton në mënyrë të veçantë ndonjë palë e tretë që e kërkon shërbimin; dhe
 - 4.2 Rastet kur shërbimi është paguar nga ngarkesa të tjera që nuk përfshijnë ngarkesat për përdorimin e Sistemit të Transmisionit.
- 5 Kostoja e kryerjes së Shërbimeve të Përrjashtuara do të mbulohet nga OST në pajtim me Shtojcën 4.
- 6 Gjatë Rishikimeve Periodike, Rregullatori mund të përshtatë profilin e të Hyrave Maksimale të Lejuara që priten të mbulohen në çdo Vit Relevant në mënyrë që të minimizojë ndryshimet e menjëhershme të të Hyrave Maksimale të Lejuara.

- 7 Gjatë tërë kohës, Vlera Neto e Tanishme e të Hyrave Maksimale të Lejuara të parashikuara duhet të jetë e barabartë me Vlerën Neto të Tanishme të kostove të lejuara të parashikuara të OST-së që priten të mbulojnë nga Ngarkesat TUOS. Kjo llogaritje e Vlerës Neto të Tanishme do të përdore Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit për OST-në, të vlerësuar nga ZRRE-ja, si normë diskontimi.
- 8 Formulatat për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara janë dhënë në Shtojcën 1.

Neni 9 Shpenzimet e Lejuara Operative

- 1 Në dorëzimin e vlerësimeve për kostot fikse dhe operative të nevojshme për tu mbuluar përmes Të Hyrave Maksimale të Lejuara gjatë çdo Periudhe Rregullative, OST-ja nuk duhet të kërkojë të mbulojë asnjë pjesë apo element të kostove korporative të ndonjë kompanie amë apo ndonjë kompanie degë që nuk mund t'i atribuohet OST-së

Neni 10 Zhvlerësimi i Lejuar

- 1 Kostoja e zhvlerësimit do të llogaritet në mënyrë lineare si funksion i Jetëgjatësisë Ekonomike dhe Bazës së Aseteve të Rregulluara për kategori të ndryshme të konsumatorëve, siç përshkruhet në Shtojcën 2.

Neni 11 Kostoja e Kthimit në Kapital

- 1 Kthimi i lejuar mbi koston e kapitalit do të llogaritet si funksion i Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit dhe Bazës së Aseteve të Rregulluara, siç përshkruhet në Shtojcën 2.
- 2 Kthimi në kapital do të llogaritet bazuar në vlerën e Bazës së Aseteve të Rregulluara në mes të çdo Viti Relevant (se mesatare e vlerës së hapjes dhe vlerës së mbylljes së Bazës së Aseteve të Rregulluara).
- 3 OST nuk do të fitojë kthim të lejuar për asetet e financuara nga grantet kapitale.

Neni 12 Kostot e Lejuara të Humbjeve

- 1 Kostoja e lejuar e humbjeve do të jetë kostoja e parashikuar e humbjeve që do të mbulojë nga PES nga OST për të kompenzuar humbjet në Sistemin e Transmisionit, dhe do të llogaritet duke përdorur Cakun e Humbjeve që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike.
- 2 Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për ndryshimet në koston e lejuar të humbjeve gjatë Përshtatjeve të Zakonshme sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1. Kjo përshtatje do të:
- 2.1 Kthejë nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove të lejuara të humbjeve gjatë Vitit Relevant, kudo që këto shkaktohen nga arsye ndryshe prej mos-arritjes së Cakut të Humbjeve;
- 2.2 Ndajë ndryshimin në mes të kostove të lejuar të humbjeve dhe kostove të realizuara të humbjeve gjatë një viti relevant, bazuar në Faktorin e Ndarjes së Humbjeve që caktohet në Shqyrtimet Periodike; dhe
- 2.3 Azhurnojë koston e parashikuar të humbjeve për Vitin Relevant vijues, bazuar në parashikimin e kostove të blerjes së energjisë me shumicë të PES.
- 3 Gjatë përcaktimit të Cakut të Humbjeve, Rregullatori do të marrë parasysh:

- 3.1 Nivelin e realizuar të Humbjeve në Transmision për periudhën më të vonshme prej 12 muajsh për të cilën ekzistojnë të dhëna të sakta;
 - 3.2 Uljet e pritshme të humbjeve gjatë Periudhës Rregullative që mund të ndodhin si pasojë e Planit të Aprovuar Investiv; dhe
 - 3.3 Nivelin e Humbjeve të Transmisionit në Sisteme të Krahasueshme të Transmisionit gjetiu në Evropë.
- 4 Faktori i Ndarjes së Humbjeve duhet të jetë i mjaftueshëm që të nxisë OST-në të reduktojë Humbjet në Transmision.
 - 5 Metodologjia e përdorur për matjen e nivelit të Humbjeve në Transmision mund të ndryshohet në bazë të një pajtimi të përbashkët në mes të Rregullatorit dhe OST-së. Në këto raste, Caku i Humbjeve do të përshtatet në mënyrë të duhur për të mos ndryshuar nivelin absolut të reduktimit të humbjeve gjatë Periudhës Rregullative.

Neni 13 Bartja e Taksës së Licencës

- 1 OSTdo të bartë koston e Taksës së Licencës. Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në Taksën e Licencës në çdo Përshtatje të Rregullt, sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.

KAPITULLI 4 NGARKESAT PËR TUOS

Neni 14 Parimet e Përgjithshme

- 1 Ngarkesat për TUOS do të caktohen herë pas herë në mënyrë që:
 - 1.1 OST-ja të mbulojë kostot e kyçjeve që nuk mbulohen nga ngarkesat e tjera; dhe
 - 1.2 Ngarkesat për TUOS të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST-ja dhe të aprovuar nga Rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Deklaratën për Parimet e Ngarkesave në Transmision të lëshuar nga Rregullatori.

Neni 15 Procedura për Aprovimin e Ngarkesave TUOS

- 2 OST-ja do t'i dorëzojë për aprovim Rregullatorit, Metodologjinë për Ngarkesat TUOS dhe amandamentimet pasuese së paku [30 Ditë Pune] para hyrjes në fuqi.
- 3 Asnjë Metodologji apo amandamentim i Metodologjisë nuk do të jetë efektiv pa aprovimin e Rregullatorit.

OST-ja ka të drejtë të vlerësojë Ngarkesat për TUOS sipas kërkesave të Nenit 14, më lartë.

KAPITULLI 5 NGARKESAT PËR OPERATOR TË SISTEMIT

Neni 16 Parimet e Përgjithshme

- 1 Ngarkesat për Operatorin e Sistemit do të caktohen herë pas herë në mënyrë që:
 - 1.1 OST të mbulojë Kostot e Operatorit të Sistemit që nuk mbulohen nga ngarkesat e tjera; dhe
 - 1.2 Kostot e Lejuara për humbje janë të përfshira në kostot e operatorit të sistemit, dhe mbulohen nga Kostot e Operatorit të Sistemit
 - 1.3 Ngarkesat për Operator të Sistemit do të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST dhe të aprovuar nga Rregullatori. Metodologjia duhet të theksoi se si do të alokohen kostot në funksionin e operatorit të sistemit dhe si do të mbulohen këto kosto nga ngarkesat. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Deklaratën për Parimet e Ngarkesave në Transmision të lëshuar nga Rregullatori

Neni 17 Procedura për Aprovimin e Ngarkesave për Operatorin e Sistemit

- 1 OST do t'i dorëzojë për aprovim Rregullatorit, Metodologjinë për Operatorin e Sistemit dhe amandamentimet pasuese së paku [30 Ditë Pune] para hyrjes në fuqi.
- 2 Asnjë Metodologji apo amandamentim i Metodologjisë nuk do të jetë efektive pa aprovimin e Rregullatorit.
- 3 OST ka të drejtë të vlerësojë Ngarkesat për Operatorin e Sistemit sipas kërkesave të Nenit 16, më lartë

Neni 18 Parimet e Përgjithshme

- 1 Ngarkesat për Operatorin e Tregut do të caktohen kohë pas kohe në mënyrë që:
 - 1.1 OST të mbulojë kostot e që nuk mbulohen nga ngarkesat e tjera; sic është autorizuar me licencë të Operatorit të Tregut
 - 1.2 Ngarkesat për Operatorin e Tregut të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST dhe të aprovuar nga Rregullatori. Metodologjia duhet të theksojë se si do të alokohen kostot në funksionin e operatorit të tregut dhe si do të mbulohen këto kosto nga ngarkesat. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Deklaratën për Parimet e Ngarkesave në Transmision të lëshuar nga Rregullatori

Neni 19 Procedura për Arovimin e Ngarkesave për Operatorin e Tregut

- 1 OST do t'i dorëzojë për aprovim Rregullatorit, Metodologjinë për Ngarkesat për Operatorin e Tregut dhe amandamentimet pasuese së paku [30 Ditë Pune] para hyrjes në fuqi.
- 2 Asnjë Metodologji apo amandamentim i Metodologjisë nuk do të jetë efektive pa aprovimin e Rregullatorit.
- 3 OST ka të drejtë të vlerësojë Ngarkesat për Operatorin e Tregut sipas kërkesave të Nenit 18, më lartë

KAPITULLI 7 TAKSAT PËR KYÇJE

Neni 20 Parimet e Përgjithshme

- 1 Taksat për Kyçje do të caktohen herë pas herë në mënyrë që:
 - 1.1 OST të mbulojë kostot e kyçjeve që nuk mbulohen nga ngarkesat e tjera; dhe
 - 1.2 Taksat për Kyçje të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST dhe të aprovuar nga Rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Deklaratën për Parimet e Ngarkesave në Transmisionit të lëshuar nga Rregullatori.
- 2 Kostot e kyçjes do të përfshijnë:
 - 2.1 Koston e punëve që kanë të bëjnë me instalimin e plantacioneve elektrike, linjave, matësve si dhe paisjeve të tjera që shfrytëzohen për ndërtimin apo modifikimin e një kyçjeje të ndonjë konsumatori përderisa këto kosto nuk mbulohen nga Ngarkesat TUOS;
 - 2.2 Koston e menjanimit të plantacioneve elektrike, linjave, matësve apo paisjeve të tjera për shkyçjen e ndonjë konsumatori nga Sistemi i Transmisionit;
 - 2.3 Normën e arsyeshme të kthimit të kapitalit që përfaqësohet nga këto kosto; dhe
 - 2.4 Koston e mirëmbajtjes së plantacioneve elektrike, linjave, matësve dhe paisjeve të tjera që përndryshe nuk mbulohen nga Ngarkesat TUOS.
- 3 Të ardhurat nga Ngarkesat për Kyçje janë të përfshira në të Hyra nga Shërbimet e Përrjashtuara siq janë definuar në shtojcën 4.
- 4 Kufiri në mes të atyre kostove që mbulohen nga Taksat e Kyçjes, kostove që mbulohen nga Ngarkesat TUOS dhe kostove që mbulohen nga ngarkesat e tjera do të definohen në Metodologjinë për përcaktimin e Taksave të Kyçjes.

Neni 21 Procedura për Aprovimin e Taksave për Kyçje

- 1 OST do t'i dorëzojë për aprovim Rregullatorit, Metodologjinë për Taksat për Kyçje dhe amandamentimet pasuese së paku [30 Ditë Pune] para hyrjes në fuqi.
- 2 Asnjë Metodologji apo amandamentim i Metodologjisë nuk do të jetë efektive pa aprovimin e Rregullatorit.
- 3 OST ka të drejtë të vlerësojë Taksat për Kyçje sipas kërkesave të Nenit 20.
- 4 Palët të cilat kyçen në Sistemin eTransmisionit kanë të drejtë të paraqesin ankesë mbi Taksat për Kyçje pranë rregullatorit, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës.

Neni 22 Parimet e Përgjithshme

- 1 OST-ja do ti mbulojë ngarkesat për Skemën Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme nga shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit
- 2 Skema Mbështetëse për Energjinë e Ripërtërishme do të jetë e identifikuar ndarazi në faturat e lëshuara nga OST-ja
- 3 Totali i të Hyrave të mbledhura, do të alokohet në konton e Fondit për Energjinë e Ripërtërishme dhe asnjë pjesë nga ajo shumë e mbledhur nuk do të mbetet në OST .

SHTOJCA 1**LLOGARITJA E TË HYRAVE MAKSIMALE TË LEJUARA**

- 1 Kjo shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara për OST-në. Kjo shtojcë komplementon parimet e dhëna në pjesën e parë të Rregullës.
- 2 Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) do të llogariten sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = UOSR_t + LSSC_t + LICC_t + KREV_t$$

Ku

MAR_t është Të Hyrat Maksimale të Lejuara

$UOSR_t$ është të Hyrat TUOS në Vitin Relevant t , të cilat caktohen në Shqyrtimet Periodike ashtu që Vlera Neto e Tanishme (përgjatë periudhës Tarifore duke marrë parasysh X-faktorin) pritet të jetë e barabartë me Vlerën Neto të Tanishme të Kostove të Parashikuara TUOS

$LSSC_t$ është kostoja e lejuar e humbjeve në Vitin Relevant t

$LICC_t$ është kostoja e Taksës për Licencë në Vitin Relevant t

$KREV_t$ është faktori korrigjues i të Hyrave në Vitin Relevant t , që parashihet si zero gjatë Shqyrtimeve Periodike

- 2.1 Të Hyrat e Lejuara TUOS ($UOSR_t$) do të llogariten gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulës në vijim:

$$UOSR_t = UOSR_{t-1} * (a_t + b_t * MDS D_t / MDS D_{t-1} + c_t * REUD_t / REUD_{t-1}) * (1 + CPI_{t-1} - X_t)$$

Ku

$UOSR_t$ janë të Hyrat e Lejuara TUOS për Vitin Relevant t

$UOSR_{t-1}$ janë të Hyrat e Lejuara TUOS në vitin Relevant $t-1$ përveç në vitin Relevant 1 ku do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga Rregullatori që bazohet nga Shqyrtimi më i vonshëm Periodik

a_t është pjesa e kostove të lejuara TUOS që nuk varet nga ndryshimii Kërkesës Maksimale në Sistemin e Shpërndarjes, Njësitë e Rregulluara të Shpërndara apo në Numrin e Konsumatorëve në Vitin Relevant t , që caktohet në Shqyrtime Periodike ku $a_t + b_t + c_t = 1$

b_t është pjesa e kostove të lejuara TUOS që varet nga ndryshimii Kërkesës Maksimale në Sistemin e Shpërndarjes në Vitin Relevant t , ku $a_t + b_t + c_t = 1$

$MDS D_t$ është vlera e parashikuar e Kërkesës Maksimale në Sistemin e Shpërndarjes për Vitin Relevant t

$MDS D_{t-1}$ është vlera e realizuar e Kërkesës Maksimale në Sistemin e Shpërndarjes për Vitin Relevant $t-1$

| | |
|--------------|--|
| c_t | është pjesa e kostove të lejuara TUOS që varet nga ndryshimi Njësive të Rregulluara të Shpërndara në Vitin Relevant t , ku $a_t + b_t + c_t = 1$ |
| $REUD_t$ | është vlera e parashikuar e Njësive të Rregulluara të Shpërndara në Vitin Relevant t |
| $REUD_{t-1}$ | është vlera e realizuar e Njësive të Rregulluara të Shpërndara në Vitin Relevant $t-1$ |
| CPI_{t-1} | është vlera e realizuar e inflacionit në Vitin Relevant $t-1$, matur duke përdorur Indeksin e Harmonizuar të çmimeve të Konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i |
| X_t | është X-faktori në Vitin Relevant t , që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike |

2.2 Kostoja e Lejuar e Humbjeve ($LSSC_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta sipas formulës:

$$LSSC_t = LSSC_{f_t} + (LSSC_{a_{t-1}} - LSSC_{f_{t-1}}) * (1 + I_t) + (LSSC_{a_{t-1}} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$

Ku

$LSSC_t$ është kostoja e lejuar e humbjeve për Vitin Relevant t

$LSSC_{f_t}$ është vlera e parashikuar e kostos së humbjeve në Vitin Relevant t , që llogaritet si:

$$LSSC_{f_t} = LT_t * WHEC_t$$

ku

LT_t është caku i humbjeve, e paraqitur si përqindje, në Vitin Relevant t

$WHEC_t$ paraqet koston e blerjes së energjisë me shumicë (shprehur në Euro) të vlerësuar për FPPEE-në në Vitin Relevant t

$LSSC_{a_{t-1}}$ paraqet koston e realizuar të humbjeve në Vitin Relevant $t-1$, të llogaritur duke përdorur Cakun e Humbjeve

$LSSC_{f_{t-1}}$ është kostoja e parashikuar e humbjeve në Vitin Relevant $t-1$, llogaritur duke përdorur Cakun e Humbjeve

I_t është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1%

$LSSC_{a_{t-1}}$ paraqet koston e realizuar të humbjeve në Vitin Relevant $t-1$, të llogaritur duke përdorur Cakun e Humbjeve

$LSAC_{t-1}$ paraqet koston e humbjeve të realizuara gjatë blerjes së energjisë nga PES si kompenzim të energjisë së humbur në Rrjetin e Transmisionit (nuk llogaritet duke përdorur Cakun e Humbjeve) në Vitin Relevant $t-1$

$LSSF_t$ është Faktori i Ndarjes së Humbjeve në Vitin Relevant t , që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike

- 2.3 Taksa për Licencë ($LICC_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën më poshtë:

$$LICC_t = LICCF_t + (LICC_{t-1} - LICCF_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

$LICC_t$ është Taksa e Licencës për Vitin Relevant t

$LICCF_t$ është Taksa e parashikuar Licencës për Vitin Relevant t

$LICC_{t-1}$ është Taksa e realizuar për Licenca në Vitin Relevant $t-1$

$LICCF_{t-1}$ është Taksa e parashikuar për Licenca në Vitin Relevant $t-1$

I_t është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1%

- 2.4 Faktori i përshtatjes së të Hyrave ($KREV_t$) do të llogaritet gjatë Përshtatjeve të Rregullta duke përdorur formulën në vijim:

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku

ARR_{t-1} paraqet të Hyrat Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant $t-1$

MAR_{t-1} paraqet të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin Relevant $t-1$

I_t është norma e interesit për Vitin Relevant t që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 1%

SHTOJCA 2

BAZA E ASETEVE TË RREGULLUARA

- 1 Kjo Shtojcë përshkruan vlerësimin e Bazës së Aseteve të Rregulluara për qëllime të llogaritjes së Zhvlerësimit të lejuar (Neni 10) si dhe kthimit të lejuar në kapital (Neni 11)
- 2 Baza e Aseteve të Rregulluara do të jetë vlerë rregullative e shumës së asetëve të përdorura dhe të përdorshme të OST-së që janë të nevojshme për kryerjen e Shërbimeve të Sistemit të Transmisionit. Baza e Aseteve të Rregulluara do të ndajë kategoritë e ndryshme të asetëve.
- 3 Regullatori do të përcaktojë vlerën fillestare të Bazës së Rregulluar të Aseteve (më 1 Prill 2012) para fillimit të periudhës së parë Regullatore
- 4 Baza e Aseteve të Rregulluara do të azhurnohet në çdo Shqyrtim Periodik si më poshtë:
 - 4.1 Kostoja e lejuar e zhvlerësimit gjatë Periudhës Rregullative të tanishme do të zbritet nga Baza e Aseteve të Rregulluara dhe do të llogaritet në mënyrë linear duke përdorur Jetëgjatësinë Ekonomike;
 - 4.2 Shitja e asetëve gjatë Periudhës së tanishme Rregullative do të zbritet nga Baza e Aseteve të Rregulluara bazuar në vlerën rregullative. Ndryshimi në mes të vlerës së shitur dhe vlerës rregullative do të zbritet nga të Hyrat Maksimale të Lejuara për Periudhën e ardhshme Rregullative.
 - 4.3 Shpenzimet e aprovuara kapitale gjatë Periudhës së tanishme Rregullative do t'i shtohen Bazës së Aseteve të Rregulluara nga data kur aset i vihet në shërbim dhe në koston e aprovuar në Planin e Aprovuar të Investimeve. Interesi gjatë ndërtimit do të kapitalizohet. Për shmangje të dyshimit, Regullatori nuk do të bëjë reduktime retroaktive të të Hyrave në të ardhmen për të marrë parasysh ndryshimin në mes të kostos aktuale dhe koston së aprovuar të investimit. Megjithatë, Regullatori do të marrë parasysh koston aktuale për Shqyrtimet e më vonshme Periodike si masë për parashikimin e investimeve në të ardhmen;
 - 4.4 Nëse një projekt kapital i aprovuar në Planin e Aprovuar Investiv nuk sillet në shërbim gjatë Periudhës Rregullative në fjalë, kostoja e tij nuk i shtohet Bazës së Aseteve të Rregulluara në Shqyrtimin vijues Periodik dhe të gjitha të Hyrat e përfituara nga aset i do të zbriten në Shqyrtimin e ardhshëm Periodik.
 - 4.5 Kurdo që kostoja e mirëmbajtjes është apo ka qenë më herët e përfshirë në shpenzimet e lejuara operative, nuk do të lejohet të kapitalizohet apo të përfshihet në Bazën e Aseteve të Rregulluara; dhe
 - 4.6 Baza e Aseteve të Rregulluara do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin përgjatë Periudhës së kaluar Rregullative, duke përdorur Indekset e Harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat.
- 5 Jetëgjatësia Ekonomike e asetëve për kategori të ndryshme të asetëve do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në Bazën e Aseteve të Rregulluara. Jetëgjatësia ekonomike do të vlerësohet gjatë Shqyrtimeve Periodike për të reflektuar jetëgjatësinë teknike të asetëve, përveç në rastet ku mund të dëshmohet se jetëgjatësia teknike ndryshon nga jetëgjatësia ekonomike e asetit.
- 6 Investimet kapitale të aprovuara do të vlerësohen gjatë Shqyrtimeve Periodike bazuar në Planin e Aprovuar Investiv për Shqyrtimin Periodik vijues. Plani i Aprovuar Investiv do të:

- 6.1 Përfshijë projektet kapitale të cilat janë të nevojshme për të ofruar Shërbimet e Sistemit të Transmision;
 - 6.2 Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
 - 6.3 Tregojë përfitimin e Konsumatorëve të Rregulluar nga çdo projekt kapital, duke iu referuar, kudo që është e nevojshme, përmbushjen e ndonjë standardi të caktuar për Sistemin e Sigurisë së Distribucionit, Standardet e Sigurisë së Operimit apo Planifikimit, siç kërkohet nga Licenca e OST;
 - 6.4 Ketë parasysh planet tjera investive apo zhvillimore të OST-së që janë aprovuar nga Rregullatori (dhe çdo ndryshim në mes të këtyre planeve duhet të identifikohet nga OST dhe të sqarohet) duke përfshirë këtu Planin Investiv 3 vjeçar të përgatitur nga OST në pajtim me Nenin 6 të Licencës dhe të Aprovuar nga ZRRE; dhe
 - 6.5 Zhvillohet duke përdorur teknika të diskontimit të rrjedhës së parasë.
- 7 Plani i Aprovuar Investiv do të implementohet si më poshtë:
- 7.1 OST do të përdorë të gjitha metodat e arsyeshme për të siguruar implementimin e Planit të Aprovuar Investiv në kohën dhe sipas orarit të aprovuar;
 - 7.2 Nëse OST, për arsye jashtë kontrollit të OST-së, dështon në implementimit të investimeve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në Planin e Aprovuar Investiv, atëherë OST duhet ta njoftojë Rregullatorin. OST duhet të japë arsye të detajuara për vonesën së bashku me orarin e ri;
 - 7.3 OST mund të aplikojë në çdo kohë te Rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në Planin e Aprovuar Investiv me ndonjë projekt tjetër kapital në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse Rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet Bazës së Aseteve të Rregulluara në Shqyrtimin Periodik të ardhshëm. Për shmangje të dyshimit, të Hyrat Maksimale të Lejuara për periudhën e tanishme nuk do të përshtaten; dhe
 - 7.4 Nëse OST e zëvendëson një projekt kapital në Planin e Aprovuar Investiv me një projekt alternativ para se të marrë Aprovimin e Rregullatorit, Rregullatori do të konsiderojë aprovimin e zëvendësimit në Shqyrtimin Periodik vijues por kjo nuk është obligative për Rregullatorin.

SHTOJCA 3

MESATARJA E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT

- 1 Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit do të llogaritet para taksave sipas formulës:

$$WACC = (1 - gi) * (rEi) / (1 - t) + gi * (rDi)$$

Ku

WACC është Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit

gi gearing (norma borxh:ekuitet) për firmën *i*

rEi kostoja reale e ekuitetit (shprehur si %) për firmën *i*

rDi kostoja reale e borxhit (shprehur si %) për firmën *i*

t norma e tatimit mbi korporatat në Kosovë

- 2 Gearing (g) do të jetë vlerë e caktuar nga Rregullatori në mes të 0 dhe 1 dhe përfaqëson pjesëmarrjen e borxhit në financimin e përgjithshëm. Vlera do të vlerësohet duke marrë parasysh financimin aktual të OST-së, financimin që është i pritshëm për biznese të ngjashme si dhe përbërjen e financimit të kompanive të ngjashme ndërkombëtare.

- 3 Kostoja e Ekuitetit (rEi) do të jetë vlerë e llogaritur nga Rregullatori duke përdorur Modelin për Vënien e Çmimeve të Aseteve Kapitale (CAPM) me formulën në vijim:

$$rEi = rf + \beta_i * ERPm$$

rf është norma pa risk

ERPm është premia për riskun në ekuitet që i aplikohet tërë tregut

βi kovarianca në mes të kthimeve të asetit të ekuitetit në fjalë dhe të asetëve të tërë tregut (beta e ekuitetit)

- 3.1 Norma pa risk (rf) paraqet koston e borxhit në Kosovë, në terma reale, dhe do të caktohet nga Rregullatori duke përdorur të dhëna nga kostoja e borxhit në Kosovë ose, në rast të mungesës së kësaj informate, koston e borxhit në shtete të cilat kanë status të njëjtë kreditor me Kosovën.
- 3.2 Premia e riskut mbi ekuitetin (ERPm) përcaktohet nga Rregullatori duke përdorur të dhëna nga premia e riskut ndërkombëtar mbi ekuitetin.
- 3.3 Beta (βi) do të përcaktohet nga Rregullatori duke përdorur të dhëna mbi betat e aplikuar për kompani të krahasueshme ndërkombëtarisht.
- 4 Kostoja e Borxhit (rDi) do të jetë mesatarja e normave të interesit për kreditë ekzistuese afatgjata (që kalojnë 1 vit) për OST-në, shprehur në terma reale dhe ponderuar sipas vlerës në Euro të secilës kredi.
- 4.1 OST është e obliguar të prokurojë huatë përmes procedurave të konkurrencës ose të demonstrojë pranë Rregullatorit se norma e interesit për huatë e marra pa prokurim

është e barabartë me, ose më e ulët se, normat e interesit në treg në kohën kur është nënshkruar marrëveshja.

- 4.2 Kur Rregullatori konsideron se norma e interesit për një hua të marrë pa prokurim komercial e tejkalon normën e interesit të tregut, atëherë ajo hua do të përjashtohet nga llogaritja e kostos së borxhit.
- 4.3 Kur Rregullatori konsideron se ka numër të pamjaftueshëm të huave për të arritur në një vlerësim të kostos së huamarrjes për OST-në, Rregullatori mund të përshtatë koston e Borxhit të llogaritur si më lartë. Kjo përshtatje do të bazohet në:
- (i) Vlerësimin e normës së interesit në treg për hua ndaj bizneseve me madhësi, risk dhe status kreditor të ngjashëm me OST-në.
 - (ii) Vlerësimin e normës së parashikuar të interesit për huatë potenciale koncesionare të OST-së.
 - (iii) Vlerësimin e përbërjes së parashikuar të huave komerciale (jo koncesionare) dhe koncesionare në borxhin e OST-së për Periudhën e ardhshme Rregullative.

SHTOJCA 4

SHËRBIMET E PËRJASHTUARA

- 1 OST mund të aplikojë një ngarkesë për kryerjen e Shërbimeve të Përfunduar, të cilat mund të jenë, por nuk kufizohen me, provizionet në vijim:
 - 1.1 Kryerjen e punëve kostoja e të cilave do të riimburohet nga një përdorues i sistemit apo ndonjë palë e tretë (duke përfshirë këtu çdo punë përforcuese) për qëllim të kyçje së një përdoruesi në Sistemin e Transmision (por vetëm deri në atë masë ku shërbimi nuk është marrë parasysht nën ngarkesat e sistemit të përshkruara në këtë Rregull);
 - 1.2 Rivendosja e linjave elektrike apo centraleve elektrike (duke përfshirë këtu edhe punët e ndërlydhura me to) si pasojë e obligimeve statusore që nuk imponohen mbi OST-në nga Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Energjinë apo Ligji për Rregullatorin e Energjisë.
 - 1.3 Lëvizjen e linjave elektrike, stabilimenteve elektrike apo pajisjeve matëse që formojnë pjesë të Sistemit të Transmisionit për të akomoduar zgjatjen, ridizajnimin apo zhvillimin e vendit në të cilin ndodhet aseti në fjalë ose në të cilin aseti është i kyçur, kostoja e të cilit do të bartet nga një përdorues i sistemit apo një palë e tretë;
 - 1.4 Kryerjen e punëve të linjave elektrike apo stabilimenteve energjetike nëse kërkohet nga një Përdorues i Sistemit të Transmisionit për të ofruar nivel të sigurisë që është më i lartë sesa që kërkohet në paragrafin e 2-të të Nenit 11 të Licencës së OST-së (Standardet e Planifikimit dhe të Sigurimit të Sistemit të Transmisionit); dhe
 - 1.5 Kryerjen e shërbimeve Matëse që nuk mbulohe nga ngarkesat e tjera në Shërbimet e Përfunduar.
- 2 Ngarkesat për këto Shërbime të Përfunduar duhen caktuar në atë nivel që i lejojnë OST-së të mbulojë:
 - 2.1 Kostot e arsyeshme të kryerjes së shërbimit; dhe
 - 2.2 Normën e arsyeshme të kthimit të kapitalit sipas shpenzimeve të bëra nga OST gjatë periudhës para marrjes së pagesës nga personi për të cilën është duke u kryer shërbimi në fjalë.
- 3 Kurdo që është e aplikueshme, këto ngarkesa duhen vlerësuar në pajtim me Metodologjinë e aprovuar të Taksave për Kyçje.
- 4 Në dhënien e ofertës ndaj personit që aplikon për kryerjen e Shërbimit të Përfunduar, OST duhet të ofrojë detaje për koston sipas kërkesës së Aplikuesit për të vlerësuar nëse Ngrakesa është e arsyeshme.
- 5 Oferta duhet t'i referohet rolit të Rregullatorit siç është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 6 Pas përfundimit të çdo Viti Relevant, OST-ja do t'i ofrojë Rregullatorit detaje të shërbimeve të ofruara si pjesë e Biznesit të Transmision të cilat janë trajtuar si Shërbime të Përfunduar nga OST gjatë Vitit Relevant si dhe të Hyrat e pranuar nga këto shërbime.
- 7 Kur Rregullatori mendon se, në bazë të parimeve të përcaktuara në paragrafet e mësipërme, ndonjë shërbim i trajtuar nga OST-ja si shërbim i Përfunduar nuk duhet të trajtohet si i tillë,

Rregullatori duhet të ofrojë udhëzime në atë drejtim dhe shërbimi në fjalë nuk do të trajtohet si Shërbim i Përrjashtuar nga data e lëshimit të këtij udhëzimi apo nga ndonjë datë tjetër që mund të specifikohet në udhëzim.

SHTOJCA 5

PROCESI I SHQYRTIMIT PERIODIK

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, Rregullatori do të publikojë në ueb-faqen zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet tjera relevante të pranuar nga OST apo palët e tjera të interesit që kanë të bëjnë me Shqyrtimin Periodik brenda [5 ditëve të punës] pas pranimit të informatave të dorëzuara nga OST, duke mos përfshirë këtu informatat që rregullatori i konsideron komercialist konfidenciale.
- 2 Rregullatori do të iniciojë Shqyrtimin Periodik jo më vonë se [gjashtë muaj] para fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative. Një orar tjetër do të vlejë gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 10.
- 3 Rregullatori do të iniciojë Shqyrtimin Periodik duke njoftuar OST-në lidhur me:
 - 3.1 Vitet për të cilat kërkohen të dhënat për vitin aktual dhe parashikimet për të ardhmen;
 - 3.2 Formatin me anë të të cilit këto të dhëna do të dorëzohen;
 - 3.3 Orarin për dorëzimin e propozimit të OST-së për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Shqyrtimin e ardhshëm Periodik; dhe
 - 3.4 Orarin për procesin e përgjithshëm të shqyrtimit.
- 4 Propozimi i OST-së do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
 - 4.1 Të Hyrat Aktuale të Rregulluara të mbledhura gjatë Periudhës së tanishme Rregullative (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
 - 4.2 Koston e realizuar për ofrimin e Shërbimeve të Sistemit të Transmision gjatë Periudhës së tanishme Rregullative, në linjë me definicionet e kostos që janë përdorur për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara;
 - 4.3 Raportin vjetor dhe pasqyrat financiare të audituara për çdo vit fiskal që ka përfunduar në Periudhën e tanishme Rregullative;
 - 4.4 Vlerën e realizuar të Kërkesës Maksimale të Sistemit të Transmision, Njësive Rregullative të Shpërndara dhe Numrin e Konsumatorëve gjatë Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.5 Vlerat e parashikuara të Kërkesës Maksimale të Sistemit të Transmision, Njësive Rregullative të Shpërndara dhe Numrin e Konsumatorëve për Periudhën e ardhshme Rregullative;
 - 4.6 Vlerën e parashikuar të Të Hyrave Maksimale të Lejuara. Duke raportuar ndaras secilin prej komponentëve të kostos së lejuar për Periudhën e ardhshme Rregullative; dhe
 - 4.7 Çdo material tjetër që Rregullatori konsideron se duhet të përfshihet në propozimin e OST-së në rastet kur Rregullatori e ka njoftuar paraprakisht dhe me kohë të mjaftueshme OST-në për afatin e dorëzimit të propozimit të OST-së.

- 5 Gjatë përgatitjes së Propozimit të saj, OST do të aplikojë plotësisht Metodologjinë e zbatuar në këtë Rregull. OST do të deklarojë të gjitha vendet ku nuk është aplikuar kjo Metodologji, arsyet për mos-aplikimin e metodologjisë, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit të përdorimit të qasjes alternative.
- 6 Pas marrjes së Propozimit të OST-së, Rregullatori do të vlerësojë saktësinë, ndëlidhjen dhe arsyeshmërinë e saj duke aplikuar metodologjinë e kësaj Rregulle, duke përfshirë këtu vlerësimin se a reflektojnë Të Hyrat Maksimale të Lejuara kostot e arsyeshme për ofrimin e Shërbimeve të Sistemit të Transmision.
- 7 Rregullatori do të përgatisë një Vendim të Përkohshëm jo më vonë se [50 ditë pune] para fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative, pas konsultimit me OST-në. Propozimi i Përkohshëm do të paraqesë propozimet e Rregullatorit për Të Hyrat Maksimale të Lejuara që do të mbulohen nga OST gjatë Periudhës Rregullative si dhe justifikimin për këtë propozim. Rregullatori mund të amandamentojë, ndryshojë apo fshijë cilëndo pjesë të Propozimit të OST-së sipas vlerësimit të tij në rastet kur Rregullatori ofron justifikim për këto amandamente, zhvendosje apo fshirje.
- 8 Në të njëjtën kohë, pas marrjes së Vendimit të Përkohshëm, Rregullatori do të fillojë procesin e konsultimit publik mbi Vendimin Fillestar në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 9 Pas përfundimit të konsultimit publik dhe jo më vonë se [20 Ditë Pune] para fillimit të Periudhës së Ardhshme Rregullative, Rregullatori duhet të marrë Vendimin Final për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Periudhën e ardhshme Rregullative. Vendimi i Rregullatorit do të jetë në pajtueshmëri me këtë Rregull. Orar alternativ do të aplikohet gjatë Periudhës Tranzitore të dhënë në Shtojcën 10.
- 10 Të Hyrat Maksimale të Lejuara të dhëna në Vendimin Final të Rregullatorit do të aplikohen nga data e fillimit të Periudhës së ardhshme Rregullative.
- 11 OST-ja mund të apelojë vendimin e Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

Shtojca 6

PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA

- 1 OST-ja do të dorëzojë te Rregullatori propozimin për Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin e ardhshëm Relevant së paku [20 Ditë Pune] para fillimit të Vitit të ardhshëm Relevant. OST po ashtu do të përfshijë në këtë dorëzim edhe dokumentet relevante dhe evidencën përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me komponentët e formulave të Përshtatjeve të Rregullta të dhëna në Shtojcën 1 si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga Rregullatori.
- 2 Rregullatori mund të kërkojë nga OST-ja që të japë sqarime shtesë për metodën e llogaritjes së propozimit për Të Hyrat Maksimale të Lejuara dhe, në këto raste, OST do të ofrojë, brenda një periudhe të shpejtë kohore, të gjitha informatat e kërkuara nga Rregullatori.
- 3 Rregullatori do ta këshillojë OST-në së paku [5 Ditë Pune] para fillimit të Vitit të Ardhshëm Relevant nëse e aprovon llogaritjen e OST-së për të Hyrat Maksimale të propozuara.
- 4 Nëse Rregullatori e aprovon propozimin për Të Hyrat Maksimale të Lejuara, atëherë këto do të jenë Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin e ardhshëm Relevant.
- 5 Nëse Rregullatori nuk e aprovon propozimin për të Hyrat Maksimale të Lejuara, Rregullatori do të japë arsyetim dhe evidencë për këtë, në pajtim me këtë Rregull. Të Hyrat Maksimale të Lejuara nuk do të ndryshojnë deri sa Rregullatori të aprovojë një propozim alternativ ose të ofrojë llogaritjen për Të Hyrat Maksimale të Lejuara.
- 6 Çdo ndryshim në të Hyra që mund të rezultojë nga llogaritja e gabuar e Të Hyrave të Lejuara raportimi i gabuar i Të Hyrave Rregullative të realizuara apo apelimet lidhur me Përshtatjen e Rregullt do të mbulohen në Vitet Relevante vijuese.
- 7 Nëse Rregullatori nuk reagon ndaj OST-së brenda kohës së kërkuar atëherë supozohet automatikisht se propozimi për të Hyrat Maksimale të Lejuara aprovohet dhe këto të Hyra bëhen efektive nga dita e parë e Vitit Relevant vijues.
- 8 OST-ja mund të apelojë çdo vendim të Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 7

PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

- 1 Nëse ka ndodhur një Ngjarje e Jashtëzakonshme, OST-ja mund të kërkojë Shqyrtim të Jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda [gjashtë muajsh] të Shqyrtimit Periodik apo para kompletimit të një Shqyrtimi të Jashtëzakonshëm të kaluar.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një Ngjarje të Jashtëzakonshme. Në këto raste kjo Shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre Ngjarjeve.
- 4 Brenda [20 Ditëve të Punës] pas kërkesës së OST-së për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm, OST duhet të dorëzojë Deklaratën për Ndikimin Financiar që do të përfshijë çështjet në vijim:
 - 4.1 Përshkrimin e Ngjarjes së Jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm;
 - 4.2 Përshkrimin e ndikimit të Ngjarjes së Jashtëzakonshme në biznesin e OST-së;
 - 4.3 Vlerësimin e ndryshimit të kostove të OST-së në çdo vit nga data e Ngjarjes së Jashtëzakonshme deri në fundin e Periudhës Rregullative;
 - 4.4 Vlerësimin për ndryshimin në të hyrat e parashikuara që rezultojnë nga Ngjarja e Jashtëzakonshme në çdo vit nga data e Ngjarjes së Jashtëzakonshme deri në përfundim të Periudhës së tanishme Rregullative;
 - 4.5 Llogaritjen për ndikimin financiar të Ngjarjes së Jashtëzakonshme në çdo vit, duke llogaritur si shuma e ndryshimeve në koston dhe të Hyrat e OST-së. Të Hyrat do të trajtohen si numër pozitiv dhe koston do të trajtohen si numra negativ; dhe
 - 4.6 Llogaritjen nëse apo jo, ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se Pragu i Materialitetit, shumëzuar me të Hyrat e OST-së (në vitin para Ngjarjes së Jashtëzakonshme), shumëzuar me numrin e viteve në mes të datës së Ngjarjes së Jashtëzakonshme dhe fundit të Periudhës Rregullative. Pragu i Materialitetit duhet të jetë një përqindje fikse që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike;
- 5 Nëse OST vlerëson se ndikimi financiar është më i lartë se Pragu i Materialitetit, OST duhet të përfshijë në Deklaratën e Ndikimit Financiar propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme në Të Hyrat Maksimale të lejuara. Propozimi për Përshtatjen e Jashtëzakonshme duhet t'u përmbahet kushteve në vijim:
 - 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë Të Hyrat Maksimale të Lejuara në atë mënyrë që Vlera Neto e Tanishme e ndryshimeve të parashikuara është e barabartë (por jo me shenjë të kundërt) me Vlerën Neto të Tanishme të ndikimit financiar të Ngjarjes së Jashtëzakonshme duke përdorur Mesatarën e Ponderuar të Kostos së Kapitalit si normë të diskontimit;
 - 5.2 Koha dhe struktura e Përshtatjes së Jashtëzakonshme do të shmangë, ku është e mundur, rritjet e menjëhershme të tarifave të konsumatorët (për shembull duke zbutur ndikimin e Përshtatjes së Jashtëzakonshme brenda disa viteve).

- 6 Rregullatori mund të fillojë Shqyrtim të Jashtëzakonshëm pa kërkesën e OST-së. Në këto raste, Rregullatori do ta njoftojë OST-në dhe do të përfshijë një përshkrim të Ngjarjes së Jashtëzakonshme si dhe një përshkrim të ndikimit të parashikuar. Pastaj, OST do të përgatisë Deklaratën për Ndikimin financiar sipas procesit të përshkruar më lartë.
- 7 Rregullatori mund të kërkojë sqarime shtesë për mënyrën e llogaritjes së Deklaratës për Ndikimin Financiar si dhe për Përshtatjen e Jashtëzakonshme dhe, në bazë të kësaj kërkesë, OST do t'i dërgojë Rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat e kërkuara.
- 8 Brenda [30 ditëve] pas marrjes së Deklaratës për Ndikimin Financiar, Rregullatori do të njoftojë OST-në nëse Rregullatori e pranon apo jo propozimin e OST-së për Përshtatjen e Jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse propozimi
 - 8.1 I plotëson kushtet e përshkruara më lartë;
 - 8.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
 - 8.3 Merr parasysh të gjitha informatat e nevojshme dhe të mundshme gjatë asaj kohe;
- 9 Nëse Rregullatori e aprovon propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme, propozimi për të Hyrat Maksimale të Lejuara do të jetë efektiv menjëherë.
- 10 Nëse Rregullatori nuk e aprovon propozimin për Përshtatjen e Jashtëzakonshme, Rregullatori duhet të ofrojë arsyetimin dhe evidencën për këtë, në pajtim me këtë Rregull. Të Hyrat Maksimale të Lejuara nuk do të përshtaten deri sa Rregullatori të aprovojë një propozim.
- 11 Nëse Rregullatori nuk e këshillon OST-në brenda afatit të kërkuar (lart), supozohet automatikisht se propozimi për Përshtatjen e Jashtëzakonshme është aprovuar dhe propozimi bëhet efektiv menjëherë;
- 12 OST-ja mund të apelojë çdo vendim të Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

SHTOJCA 8

NGJARJET E JASHTËZAKONSHME

- 1 Ngjarja e Jashtëzakonshme ndodhë në rastet e mëposhtme:
 - 1.1 Çdo ndryshim mbi 3% në taksat e aplikueshme në Kosovë dhe që nuk mbulohet tërësisht në Përshtatjet e Rregullta;
 - 1.2 Çdo forcë madhore që është definuar në Shtojcën 9;
 - 1.3 Çdo ngjarje tjetër që përmbushë të gjitha kushtet në vijim:
 - (i) Nuk është paraparë në mënyrë të arsyeshme;
 - (ii) Nuk ka qenë nën kontrollin e OST-së;
 - (iii) OST-ja nuk është e obliguar ta ndalojë atë;
 - (iv) Nuk do të mbulohet në Përshtatjet e Rregullta; dhe
 - (v) Ndryshon në masë të konsiderueshme të Hyrat dhe/ose kostot e OST-së për ndonjë periudhë të caktuar 12 mujore, në atë mënyrë që mund të vlerësohet që mund të tejkalohet Pragu i Materialitetit (i sqaruar në Shtojcën 7)
- 2 Ndodhja e Ngjarjes së Jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të filluar Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm por, siç është sqaruar në Shtojcën 7, Ngjarja duhet të kalojë Pragun e Materialitetit në mënyrë që të përshtaten Të Hyrat Maksimale të Lejuara.

SHTOJCA 9

NGJARA E FORCËS MADHORE

- 1 Forca Madhore është ngjarje e jashtëzakonshme apo rrethanë që i përmbushë të gjitha kushtet në vijim:
 - 1.1 Është jashtë kontrollit të OST-së;
 - 1.2 OST-ja nuk ka mundur ta parandalojë atë;
 - 1.3 OST-ja nuk ka mundur ta shmangë apo ta tejkalojë; dhe
 - 1.4 Nuk i atribuohet OST-së.
- 2 Forca madhore mund të përfshijë, por nuk kufizohet me ngjarjet e veçanta apo rrethanat e paraqitura më poshtë atëherë kur kushtet e lartpërmendura janë përmbushur:
 - 2.1 Luftë, gjendje lufte apo veprime ushtarake (pavarësisht se a është deklaruar luftë apo jo), invazion, akt i armiqve të jashtëm;
 - 2.2 Rrebelim, terrorizëm, sabotim nga persona që nuk janë punonjës të OST-së, kontraktorë apo nënkontraktorë, revolucion, kryengritje, uzurpim apo luftë civile;
 - 2.3 Trazirë, rrëmuje, grevë apo lokaut nga persona që nuk janë punonjës, kontraktorë apo nën-kontraktorë të palës;
 - 2.4 Municione të luftës, materiale eksplozive, rrezatim ionizues apo kontaminim me radioaktivitet, përveç kur këto mund t'i atribuohen përdorimit të palës; dhe
 - 2.5 Katastrofat natyrore si tërmeti, tsunami, tajfuni apo aktivitetet vullkanore.